

TË DREJTAT E VIKTIMAVE TË E DHUNËS

Ju (viktima) keni të drejtë:

- të denonconi pranë çdo Stacioni Policie, ku jetoni apo ndodheni;
- t'i drejtoheni Njesisë Administrative ose Qendrës Shëndetësore ku banoni;
- të telefononi (*ju ose te afërmit tuaj*) në çdo moment, për të raportuar dhunën në numrin e Policisë së Shtetit pa pagesë **112**;
- të trajtoheni me dinjitet, pa diskriminim;
- të kërkoni plotësimin e kërkesë padisë për urdhër mbrojtjeje nga dhunuesi/ja;
- të bëni kallëzim penal për dhunuesin/en;
- të keni ndihmë ligjore falas;
- t'ju sigurohet mbrojtje e menjëhershme, ju dhe familjarëve tuaj;
- të kërkoni strehim në një Qendër për Viktimat e Dhunës;
- të keni kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të dhunës.